

BASHKIA GRAMSH
NR REGJ 377
Mbërriti me Dûte

25 - 01 2014



BASHKIA GRAMSH

RELACION TEKNIK

“NDËRTIM PRITA PËR MBROJTJE NGA LUMI DEVOLL”



DHJETOR -2023-

Të përgjithshme



Qyteti i Gramshit pozicionohet ne jug-lindje , i cili karakterizohet nga një relief kodrinor –malor dhe klime relativisht te ftohte ne dimer dhe te nxehet ne vere. Ky qytet ndodhet ne një lartesi prej 200 m mbi nivelin e detit dhe pershkohet nga disa lumenj e perenj si. Lumi i Devollit,lumi i Tomorrice,lumi Holtes etj... Gramshi ka një popullatë prej afersisht 14.000 banore si qytet dhe karakterizohet nga siperfaqe te konsiderueshme bujqesore, te cilat here pas here perfshihen nga perbytjet e lumenjve si rezultat i fryrjes dhe daljes nga shtrati i ketyre lumenjve.Qyteti i Gramshit ndahet ne disa lagje te cilat pjeserisht janë te sistemuara dhe nuk perbejne rrezik per permbytje ,kurse pjeserisht një lagje here pas here rrezikohet nga permbytje si rezultat i prurjeve te lumit Devoll, gjithashtu ne kete zone rrisku perfshihen edhe toka bujqesore.

Gjendja aktuale e tokave bujqesore pa prite ndaj lumit Devoll –


Zona ne te cilen shfaqet problematika ndodhet ne drejtimin perendifor te qytetit te Gramshit ose ne te djathje te hyrjes. Ky territor karakterizohet nga toke bujqesore dhe duke iu afruar fundit te skarpates ku ngrihet pjesa me meadhe e qytetit ndodhen edhe objekte banimi, te cilat me pare kane qene objekte me funksion industrial (gjate sistemi). Duhet theksuar se i gjithe ky territor apo toke bujqesore shtrihet deri ne kufijt jugor te qytetit,ku sipas matjeve nga google earth shkon ne një gjatesi afersisht ose perafersisht 1502 m, me një siperfaqe te perafert nga Asig 226.846 m².Kushtet e keqija klimaterike nuk mund te kontrollohen,por puna parandaluese ndaj pasojave qe mund te shkaktoje eshte një domosdoshmeri prane qendrave te banuara dhe tokave bujqesore.Erozioni i zones dhe brigjeve lumore i shkakton deme shume te medha ekonomise se një vendi por kjo behet me e theksuar per ekonomine e një Bashkie modeste.Ky dem disa here nuk bie menjehere ne sy,por shpesh shkakton nderlikime serioze me pasoja te renda katastrofike. Zona per te cilen po i nenshtrohet ky studim dhe si rrjedhoje si investim,ka nevoje per pritje lumore. Kjo prite do te ndertohet me gabione.

Duhet theksuar se kjo zone ka pesuar eriozion si rezultat i gerryerjes lumore te lumit Devoll dhe cdo vit humbet toka bujqesore. Gerryerja e lumit Devoll ne pjese jugore perben shkak rreziku per skarpaten qe e kufizon,ku per me teper ngrihet një bllok banimi . Keto evidentimente janë konsatauar nga grupi i inspektimit prane Bashkise se Gramshit.

Keto permbytje te tokave bujqesor nder vite qe ndodhin,bjene te domosdoshme rritjen e sigurise ndaj vershimeve dhe fryerjes se lumit duke ngritur prita mbrojtese sipas kushteve teknike te projektimit.Per kete arsyе grupi i projektimit prane Bashkise se Gramshit,filloj punen mbi hart nin e projektit mbi pritat lumore nga gerry rja e tokave bujqesore.Nga nspektimi eshte konstatuar se vershimi i iedhjes lumore te lumit Devoll,perben here pas here rrezik per banesat e modifikuara dhe te pri atizuara qe ndodhen ne afersi apo kufi te tokave bujqesore. Ne foto dallohet qartesisht, se si pasoje e vershimeve , lumi ka devijuar nga shtrati i vet natyral, duke eroduar te gjithe tokat bujqesore.



DHJETOR -2023-



DHJETOR -2023-

Vizioni i ndertimit te prites ndaj lumbit Devoll –

Nepermjet projektimit dhe zbatimit te kesaj vepre prita lumore me garbion me rrjet teli ndaj lumbit Devoll,parashikohet ti jepet fund gerryerjes dhe erozionit te tokave bujquesore. Gjithashtu benefite do te pasqyrohen edhe tek objektet e banimit te permendura me lart, ku qytetaret nuk do te kene me shqetesime per permbytjen e shtepive.

Ky projekt do ti jape zgjidhje perfundimsht daljes nga shtrati te lumbit Devolli,I cili per te gjithe gjatesine apo intinerarin e kesaj zone qe do mbrohet ,nuk do te penetroje me ne brendesi te tokave bujquesore .

Objekti kryesor eshte rritja e aftesive ujiteze dhe te kullimit dhe mbrojtja nga pembytjet lumore e tokave bujquesore .

Punoi :

Ing. Orgent Çoniku



Miratohet :

Kryetari

Besion AJAZI

